


KA.nr.19/2013



GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Biljana Rexhiq dhe Mejreme Zekaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunorës profesionale Sabahate Hoti, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Agjencioni Kundër Korrupsionit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj, Regj.I.nr.11519/2012 të dt. 29.11.2012, në bazë të nenit 31, al.3,39 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më dt.28.01.2013, mori

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**

ABROGOHET aktvendimi i goditur dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj, me aktvendimin, Regj.I.nr.11519/2012 të dt. 29.11.2012, ka pezlluar procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Kemajl Ramush Ramadani, nga Ferizaji, për kundërvajtjen nga neni 17 par.1 pika 3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, në mungesë të provave, e në vështrim të nenit 198, al.1, pika 1. të Ligjit për Kundërvajtje.

Kundër këtij aktvendimi Agjencioni Kundër Korrupsionit, ka paraqitur ankesë për shkak të: shkeljeve ligjore dhe vendimit mbi pezullim, ashtu siqë rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Thekson se njoftimi i zyrtarëve të lartë publik është i rregulluar me nenin 4. Të Ligjit nr.04/L-050 dhe të gjitha faktet dhe rrethanat dëshmojnë se i pandehuri ka kryer kundërvajtje për mosë deklarim të pasurisë, andaj ka propozuar që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim meritor.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoj ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, deklarinimin të dhënë të pandehurit në seancën e shqyrtimit kryesore, pranë gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt.26.09.2012, i cili nuk e ka pranuar kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, deklarinimin e dëshmitarit Naser Musa, zyrtari i pikës kontaktuese, me zyrën e Agjencionit Kundër Korrupsionit në Kuvendin Komunal në Ferizaj, deklarinimin e zyrtarit Afrim Matoshi, zyrtar për marvajtje të Kuvendit të K.Ferizaj, deklarinimin e dëshmitarit Agron Behrami, zyrtar i AKK-së, si dhe shkresat e tjera e lëndës, andaj ka gjetur se:

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, si dhe bëri shikimin e shkresave të lëndës dhe konstatoi se për këtë çështje kundërvajtëse duhet të bëhet plotësimi i procedurës së provave. Kolegji vlerëson se dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me nenin 204 të Ligjit për Kundërvajtjet se nuk përmban të dhëna personale të sakta për të pandehurin se "është e martuar, tre fëmijë, shkollën e mesme dhe absolvente e shkollës së lartë".

Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë administrimin e të gjitha provave, meqë, dëshmitari Afrim Matoshi nuk dëshmon në mënyrë të plotë për veprimet që janë ndërmarrë për njoftimin e deputetëve për plotësimin dhe dorëzimin e formularëve për deklarimin e pasurisë. Kurse, dëshmitari Naser Musa, në dëshmi e tij thekson se së bashku me kryesuesin e Ansambles Komunale vendosëm që komunikimin ta bëjmë në këtë mënyrë drejtpërdrejtë, pasi që të gjithë delegatet nuk posedojnë imella, pa dhënë sqarimet të mjaftuara dhe pa prezentuar prova për shkresat e lëndës. Ndërsa, nuk është administruar ndonjë provë tjetër për vërtetimin e përgjegjësisë kundërvajtëse.


Andaj, për këto arsye, kolegji vlerëson se aktvendimi i goditur nuk mund të qëndroj dhe është abroguar që në plotësim të procedurës, gjykata e shkallës së parë duhet të marr në pyetje në cilësi të dëshmitarit kryesuesin e Asambles Komunale, Agim Aliun, i cili duhet të deklarohet se si i ka njoftuar në mënyrë drejtpërdrejtë, dhe nga foltorja të gjithë pjesëmarrësit dhe të pandehurin se duhet të plotësojnë formularet për deklarimin e pasurisë, që duhet ti dorëzojnë në AKK, dhe të prezentoj regjistrinë e antarëve pjesëmarrës të KK-së në mbledhjen e dt.09.03.2012 dhe sipas nevojës të administroje edhe prova të tjera duke bërë edhe ballafaqimin e të pandehurit me dëshmitarin, e pastaj, pas vlerësimit të plotë të gjendjes faktike, duke vlerësuar prova të nxjerrura një nga një e në tërësi të vendos lidhur me këtë çështje kundërvajtëse.

Më sa u tha më lartë konform nenit 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
KA.nr.19/2013 të dt. 28.01.2013

Procesmbajtëse,
Sabahate Hoti



KRYETARI I KOLEGJIT,
Ramiz Kuqi